DOKUMENTI I POLITIKAVE TË ARSIMIT TË LARTË 2030

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

PSE NJË DOKUMENT I POLITIKAVE PËR ARSIMIN E LARTË?

- Për të analizuar ecurinë e transformimit të Arsimit të Lartë 2015 – 2024;
- Për të vlerësuar pikat e forta dhe sfidat e sistemit të arsimit të lartë bazuar në kuadrin legjislativ, qeverisës dhe impaktin në shoqëri;
- Nevoja për të patur një udhërrëfyes për prioritetet dhe masat për thellimin e reformës në Arsimin e Lartë.

PSE NJË DOKUMENT I POLITIKAVE PËR ARSIMIN E LARTË?

SISTEMI - MË SHUMË CILËSI - ADAPTUESHMËRI - INOVACION

1. Zhvillim të kapaciteteve kërkimore (raport i matshëm mës kërkimit shkencor / mësimdhënies);
2. Financim SMART Universiteteve / Përthithje e fondeve dhe programeve të EU;
3. Matje periodike e efektivitetit dhe raportit të përdorimit të burimeve financiare dhe humane;
4. Incentivim i bashkëpunimit ndërkombëtar;
5. Thithje e studentëve vendas dhe të huaj / diploma të përbashkëta;
6. Rankimi ndërkombëtar – qëllim i çdo Universiteti.

PROCESI I HARTIMIT TË DOKUMENTIT

Grupi i punës u ngrit me Urdhër nr. 656, datë 22.11.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e "Dokumentit të politikave të zhvillimit të arsimit të lartë 2014-2030"

Në përbërje të të cilit janë
15 Anëtarë
dhe
3 Sekretariat Teknik:

- **7 Profesorë** nga institucionet e arsimit të lartë
- **5 anëtarë** nga MAS
- **3 anëtarë** nga ASCAL, AKFAL, AKKSHI
- **3 sekretariat** Teknik MAS

Përfshirje e ekspertëve të Bankës Botërore; mbi Rapid Assessment on Albania's Tertiary Education: Toward Transformation Roadmap (May 2024)

Takime, diskutime, analiza, fokus grupe, studime literature, etj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DEKLARATA E VIZIONIT 2030

Përmes Arsimit të Lartë, Shqipëria të bëhet një vend i njohur për **ekselencën akademike, inovacionin** dhe biznesin konkurues dhe një vend tërheqës për të jetuar dhe punuar. Institucionet e arsimit të lartë të sigurojnë një **angazhim të fortë me studentët, komunitetet, shoqërinë dhe biznesin**, duke i dhënë studentëve më shumë përkatësi dhe identitet, dhe duke i pajisur me aftësitë e duhura për të kontribuar brenda dhe jashtë vendit drejt **përputhshmërisë me Zonën Europiane të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.**

Arsimi i Lartë të jetë **promotor i ideve të reja, përmes kërkimit shkencor**, duke mundësuar përkthimin e këtyre ideve në biznese të qëndrueshme dhe inovative të së ardhmes, të mbështesë ndryshimin përmes qasjeve inovative tek **të mësuarit dhe mësimi i bazuar në kërkim**, tek vlerësimi i studentëve dhe një sistem i garantuar i sigurimit të cilësisë – të gjitha këto për të ushqyer kreativitetin dhe inovacionin.

Arsimi i lartë në Shqipëri të udhëhiqet nga **ndërkombëtarizimi, përmes profilizimit dhe diversifikimit të ofertës akademike** të orientuar drejt nevojave të tregut të punës, duke u bërë edhe më tërheqës për studentët vendas dhe të huaj, me fokus kërkim shkëncor cilësor me impakt rajonal, kombëtar dhe në tregun global.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

ÇFARË PËRMBAN DRAFT - DOKUMENTI

1. Hyrje. Pse një Dokument Politikash?

2. Kuadri i përgjithshëm.

3. Arsimi i lartë Shqiptar drejt 2030. Synimet dhe objektivat kryesore për të ardhmen:
   - Qëllimi i Dokumentit të Politikave
   - Objektivat Strategjike dhe Objektivat Specifike

4. Plani i Veprimit, Rekomandime, Indikatorët e matshëm, Afatet kohore, Institucionet përgjegjëse.

QËLLIMET E POLITIKËS PËR ARSIMIN E LARTË NË SHQIPËRI

Qëllimi 1

Arsimi i lartë si faktor i rëndësishëm për zhvillimin e kapitalit njerëzor, social dhe ekonomik të vendit, të sigurojë një ofertë të re akademike, për t'u përshtatur me kërkesat dinamike të tregut të punës, duke pajisur studentët me aftësitë e të ardhmes dhe rritur produktivitetin.

Qëllimi 2

Integrimi i arsimit të lartë në Zonën Europiane të Arsimit dhe Kërkimit Shkencor, përmes fuqizimit të mekanizmave të financimit dhe sigurimit të cilësisë si dhe ndërkombëtarizimit dhe specializimit të arsimit të lartë.

QËLLIMI I

Qëllimi 1
Arsimi i lartë si faktor i rëndësishëm për zhvillimin e kapitalit njerëzor , social dhe ekonomik të vendit, të sigurojë një ofertë të re akademike, për t'u përshtatur me kërkesat dinamike të tregut të punës, duke pajisur studentët me aftësitë e të ardhmes dhe rritur produktivitetin;

Objektivi strategjik 1.1: Përmirësimi i ofertës akademike që synon fuqizimin e kapitalit njerëzor	**Objektivi specifik 1.1.1:** Krijimi i një mjedisi tërheqës për studentët nëpërmjet diversifikimit të ofertës akademike që siguron njohuri, praktikë dhe punësim.
	Objektivi specifik 1.1.2: Rishikimi i formulës së financimit të IAL me bazë performance dhe cilësie
	Objektivi specifik 1.1.3: Riorganizimi i kuadrit ligjor për të mundësuar adaptueshmërinë me tregun e punës



Objektivi strategjik 1.1: Përmirësimi i ofertës akademike që synon fuqizimin e kapitalit njerëzor

REKOMANDIME

- Rishikimi i Ligjit për Arsimin e Lartë;
- Instrumenta ligjore të cilët lehtësojnë adaptimin e programeve të studimit në përputhje me kërkesat e trgut të punë (drejtimet Major/Minor) dhe krijojnë perspektiva të reja për studentët për tu adaptuar në tregun e punës;
- IAL të synojnë matjen e punësimit të studentëve të diplomuar dhe kohën e punësimit duke e lidhur me incentiva financiarë për programin dhe kuotat e studimit;
- Vlerësimi e financimi IAL publike nga AKFAL mbi bazë performance dhe cilësie;
- Ndërtimi i mekanizmave të qëndrueshëm të bashkëpunimit IAL-Biznes, zhvillimi i partneriteteve me industrinë dhe sektorët e tjerë për të ofruar praktika profesionale dhe mundësi punësimi për studentët;
- Krijimi i shërbimeve të larmishme për studentët e përmirësimi i tyre i vazhdueshëm, përmes instrumentave të rinj të mbështetjes financiare (kredia studentore), rritjes së bursave për studentët ekselentë, atyre të degëve prioritare dhe ata nga grupet e margjinalizuara;
- Mundësi për studentët që të përmirësojnë arritjet e tyre akademike duke nxitur krijimin e fuqizimin e Zyrave të Progresit Akademik e Këshillimit të Karrierës, futjen e mentorimit (këshillimit) akademik në rastet kur mungon, si dhe Nxitje për krijimin e Rrjeteve të Ish Studentëve (Alumni Association);
- Zgjerim dhe përmirësim të cilësisë të Programit Kombëtar të Praktikave për studentët;

Objektivi strategjik 1.1: Përmirësimi i ofertës akademike që synon fuqizimin e kapitalit njerëzor

INDIKATORËT E PERFORMANCËS

- Numri i programeve të studimit dhe kurrikula të përditësuara, rishikura e akreditura në përputhje me vlerësimet e nevoja të tregut të punës e biznesit;
- Numi i pedagogëve të rinj të kualifikuar dhe lektorëve vizitorë nga universitete të huaja dhe diaspora shkencore;
- Numri i marrëveshjeve IAL-Biznes –Administratë Publike;
- Rritje e % të studentëve që punësohen në subjekte publike e private sipas profilit të studimit;
- Përqindja e financimit publik për bursa studentësh;
- Numri i studentëve të mentoruar dhe gjurmimi i punësimit të studentëve;
- Tregues të performancës akademike të stafit.

QËLLIMI I

Qëllimi 1

Arsimi i lartë si faktor i rëndësishëm për zhvillimin e kapitalit njerëzor, social dhe ekonomik të vendit, të sigurojë një ofertë të re akademike, për t'u përshtatur me kërkesat dinamike të tregut të punës, duke pajisur studentët me aftësitë e të ardhmes dhe rritur produktivitetin;

Objektivi strategjik 1.2: Forcimi i lidhjeve me tregun e punës dhe profilizimi i universiteteve, bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale	**Objektivi specifik 1.2.1:** Nxitja e profilizimit rajonal të institucioneve të arsimit të lartë, me një ofertë akademike dhe programe studimi bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale
	Objektivi specifik 1.2.2: Bashkëpunimi me sektorin privat, zhvillimi i partneriteteve me industrinë dhe sektorët e tjerë për të ofruar praktika profesionale dhe mundësi punësimi për studentët
	Objektivi specifik 1.2.3: Institucionet e arsimit të lartë, të kthehen në qendra për zhvillimin dhe shpërndarjen e dijes duke ofruar edhe shërbime ndaj të tretëve.



Objektivi strategjik 1.2: Forcimi i lidhjeve me tregun e punës dhe profilizimi i universiteteve, bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale

REKOMANDIME

- Realizimi i përvitshëm i Anketës Kombëtare Nevojat për Specialistë të Lartë në Tregun e Punës në bashkëpunim IAL-Biznes – INSTAT sipas një metodologjie të unifikuar në mënyrë që të përputhen programet kombëtare të studimit e kurrikulat e tyre me këto;
- Profilizimi rajonal i Institucioneve të Arsimit të Lartë, ku një fokus i veçantë t'i jepet dhe programeve të mësuesisë;
- Nxitja e krijimit të Programeve të Studimit në IAL me karakter ndërdisiplinor sipas qasjes (Kryesore/Major-Dytësore/Minor) që krijojnë zhdërvjelltrësi për punësimn e formim të vazhdueshëm pasuniversitar dhe Programeve të Studimit STEM;
- Ndryshimi i kuadrit ligjor me qëllim njohjen dhe përfshirjen e programeve profesionale në punësim;
- Forcimi i dialogut dhe i rolit të biznesit dhe partnerëve profesionalë në projektimin dhe rishikimin e programeve të studimit;
- Forcimi i aftësive praktike dhe nxitja e kualifikimeve për zhvillim të qëndrueshëm.

Objektivi strategjik 1.2: Forcimi i lidhjeve me tregun e punës dhe profilizimi i universiteteve, bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale

INDIKATORËT E PERFORMANCËS

- Lidhja e të dhënave sasiore e cilësore të Anketës Kombëtare Nevojat për Specialistë të Lartë në Tregun e Punës me numrin e programeve të studimit të reja, të përditësuara dhe të akredituara;
- Numri i IAL që i nënshtrohen proceseve të Strategjisë së Transformimit e Profilizmit në bazë të vlerësimit të kapaciteteve akademike e kërkimore sipas nevojave të zhvillimit në nivel kombëtar e rajonal;
- Numri i Programeve të reja të studimit me karakter ndërdisiplinor të krijuara nga IAL –të e akredituara nga ASCAL dhe numri e përqindja e rritur e studentëve që ndjekin programet STEM;
- Numri dhe përqindja e rritur e maturantëve që ndjekin Programet Profesionale të Studimit (2 vjecar) në IAL që i ofrojnë ato;
- Numri i programeve të studimit të krijuara, të përditësura e akreditura nga ASCAL falë dialogut IAL- Biznes;
- Numri i kontratave apo marrëveshjeve IAL-Kompani Biznesi për zhvillimin e praktikave profesionale dhe numri i studentëve që ndjekin programe kombëtar e ndërkombëtare për kualifikim të vazhdueshëm.

QËLLIMI II

Qëllimi 2

Integrimi i arsimit të lartë në Zonën Europiane të Arsimit dhe Kërkimit Shkencor, përmes fuqizimit të mekanizmave të financimit dhe sigurimit të cilësisë si dhe ndërkombëtarizimit dhe specializimit të arsimit të lartë

Objektivi strategjik 2.1: Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor nëpërmjet ndërkombëtarizimit, financimit të qëndrueshëm dhe inovacionit	**Objektivi specifik 2.1.1:** Fuqizimi i kërkimit shkencor në IAL përmes rritjes së financimit, gjithëpërfshirjes, ndërkombëtarizimit dhe shkencës së hapur.
	Objektivi specifik 2.1.2: Fuqizimi i standarteve të cilësisë në mësimdhënie përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm të tyre.
	Objektivi specifik 2.1.3: Matja e përformancës në kërkim shkencor e projekte, si bazë për një financim të qëndrueshëm



Objektivi strategjik 2.1: Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor nëpërmjet ndërkombëtarizimit, financimit të qëndrueshëm dhe inovacionit

REKOMANDIME

- Hapja e degëve dhe Universiteteve ndërkombëtare me synim diversifikimin e ofertës akademike;
- Fuqizimi i rolit të grupeve mësimore - kërkimore brenda departamenteve
- Nxitja e IAL-ve për të hapur programe studimi të përbashkëta me IAL-të evropiane ose programe në gjuhën angleze;
- Bashkëpunimin në fushën shkencore, ku duhet të investohet për projekte të përbashkëta dhe aplikime në fondet evropiane. Në këtë kuadër diaspora akademike ka një rol të veçantë;
- Angazhimi afatshkurtër dhe afatgjatë i diasporës akademike në institucionet e arsimit të lartë
- Lidhja e Programeve të Studimit të Doktoraturës me prioritetet social ekonomike dhe politike te vendit dhe krijimi i Bazës Kombëtare Online të të Dhënave të Doktoraturës sipas fushave të studimit në të dy periudhat kohore 1957-1990; 1990-2024;
- Vlerësim për arritje ekselente në shkencë për personelin akademik dhe përmiresim i metodologjisë kombëtare të vlerësimit të kerkimit shkencor në IAL përmes platfmorës ACRIS; raportim nga IAL për të dhënat lidhur me kërkimin shkencor
- Rritja e pjesëmarrjes së diasporës akademike në kërkim shkencoe dhe mësimdhënie.

Objektivi strategjik 2.1: Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor nëpërmjet ndërkombëtarizimit, financimit të qëndrueshëm dhe inovacionit

INDIKATORËT E PERFORMANCËS

- 50% e programeve të studimit të jenë rezultat i bashkëpunimit me IAL-të evropiane ose zhvillohen në gjuhë të huaja;
- Numri i programeve të IAL-ve të huaja që ofrohen në Shqipëri;
- Numri studentëve të huaj si përqindje e numrit total të studentëve në arsimin e lartë në Shqipëri;
- Shuma totale e buxhetit për projektet ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik e disbursuar nga IAL-të shqiptare;
- Rritje me 50% të numri i muajve të mobilitetit për personelin akademik dhe për studentët
- Numri dhe kohëzgjtja e angazhimit të përfaqësuesve të diasporës shkencore shqiptare në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe proceset e akreditimit.
- Treguesit e përformancës së stafit akademik në kërkim shkencor e projekte;
- Përfshirja e performancës në platformën ACRIS;
- Vendosja dhe zbatimi i incentivave (stimujve) për rezultate në punën shkencore

QËLLIMI II

Qëllimi 2
Integrimi i arsimit të lartë në Zonën Europiane të Arsimit dhe Kërkimit Shkencor, përmes fuqizimit të mekanizmave të financimit dhe sigurimit të cilësisë si dhe ndërkombëtarizimit dhe specializimit të arsimit të lartë

Objektivi strategjik 2.2: Fuqizimi i arsimit të lartë si katalizator i zhvillimit social, ekonomik dhe dixhital drejt integrimit në BE	**Objektivi specifik 2.2.1:** Dixhitalizimi i proceseve akademike e kërkimorë në IAL drejt universitetit 4.0
	Objektivi specifik 2.2.2: Sigurimi i pavarësisë së ASCAL në përputhje me udhëzimet e standardet europiane të cilësisë (ESG)
	Objektivi specifik 2.2.3: Krijimi i mekanizmave të kontrollit të cilësisë për programet e studimit



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Objektivi strategjik 2.2: Fuqizimi i arsimit të lartë si katalizator i zhvillimit social, ekonomik dhe dixhital drejt integrimit në BE

REKOMANDIME

- Forcimi i qasjes së mësimdhënies akademike në formë të përzier (blend) në auditorë dhe online duhet të shihet si një mundësi për modernizimin e aspekteve të mësimdhënies, hapësira më të mëdha për të përfshirë staf akademik (profesorë vizitorë) nga universitete të ndryshme të botës apo ekspertë të një fushe të caktuar (lektorë të ftuar);
- Krijimi i një infrastrukture të qëndrueshme të mësimdhënies akademike në tre format e saj: Tradicionale (auditor), Online dhe të përzier (Auditor&Online);
- Nxitja e krijimit të mekanizmave ligjorë, institucionalë e financiarë që i shtyjnë IAL drejt qasjes së Universitetit 4.0;
- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Digitalizimit të Arsimit 2025-2029;
- Ndërtimi Bazës Kombëtare Online të të Dhënave të Bibliografisë Kombëtare Shkencore (1946-1990 e 1990-2024) dhe Infrastrukturave Digitale Online (arkiva, revista shkencore, biblioteka online);
- Amendimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi për të siguruar pavarësinë e ASCAL dhe Bordit të Akreditimit në përputhje me udhëzimet e standardet europiane të cilësisë (ESG);
- Përfshirja e studentëve, punëdhënësve, grupet e interesit, në proceset e sigurimit të cilësisë dhe integritetin e arsimit të lartë;
- Rritja e pjesëmarrjes së diasporës akademike në proceset e vlerësimit të jashtëm të cilësisë;
- Futja e procesit të apelimit në vlerësimin e jashtëm dhe vendimeve të Bordit të Akreditimit, në përputhje me udhëzimet e standardet europiane të cilësisë (ESG).

Objektivi strategjik 2.2: Fuqizimi i arsimit të lartë si katalizator i zhvillimit social, ekonomik dhe dixhital drejt integrimit në BE

INDIKATORËT E PERFORMANCËS

- Metoda të reja mësimdhënie, të përziera, online, në distancë;
- Rritje e investimeve në infrastrukturën dixhitale;
- Krijimi, përditësimi i vazhdueshëm e funksionimi me akses të hapur të Bazës Kombëtare Online të të Dhënave të Bibliografisë Kombëtare Shkencore (1946-1990 e 1990-2024) dhe Infrastrukturave Dixhitale Online (arkiva, revista shkencore, biblioteka online);
- Rritja e pavarësisë së ASCAL në përputhje me ESG për anëtarësimin me të drejta të plota në ENQA;
- Sistem apelimi brenda strukturës së ASCAL dhe BA në përputhje me ESG;
- Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe infrastrukturore të ASCAL;
- Studentë dhe përfaqësues të industrisë në procesin e akreditimit;

REKOMANDIME (PËR DISKUTIM)

PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE

THELLIMI I REFORMËS NË ARSIMIN E LARTË:

Rritja e nivelit të panvarësisë së Bordit të Akreditimit dhe ASCAL.

Financimi dhe modelet e financimit (raporti mesimdhënie/kërkim shkencor + investimet në R&D).

Edukimi në distancë (on-line learning, blended etj).

Përdorimin e infrastrukturave universitare, apo infrastrukturave të tjera në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si infrastruktura të hapura

Profilizimi i Universiteteve Rajonale

Mobiliteti i studentëve dhe stafeve akademike, më qëllim pjesëmarrjen në projektet e ndryshme ndërkombëtare

Roli i Diasporës Akademike në nivelet e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe qeverisjes universitare.

Rankimi kombëtar dhe ndërkombëtar i IAL-ve (matjen e performancës kërkimore dhe shkencore për stafin akademik).

Ndërkombëtarizimi dhe hapja e kampuseve të IAL-ve të huaja apo degëve të tyre në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet IAL-ve publike dhe jo publike, si dhe vet IAL-ve të huaja

Programe të reja për nxitjen e disiplinave – "Chaire Universitare" për kërkimin – shkencor në IAL/mes IAL brenda dhe jashtë vendit

Krijimi i bazës së informacioni për llogaritjen e treguesve GERD (gross domestic expenditures in R&D) dhe GBARD (government funding of R&D).